



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK VAU I DEJËS

**Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të  
njeriut.**

Datë 23/05/2025

**RAPORT VENDIMMARRJE**

**Drejtuar:** Këshillit të Bashkisë

**Lenda:** Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 6 datë 9/05/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Prill 2025"

**Analiza ligjore:**

Bazuar në ligjin nr. 139, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar; Ligjin nr. 57/2019, datë 18.7.2019, "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë"; VKM-në nr. 597, datë 4.9.2019, "Për Përcaktimin e Procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndhmën Ekonomike", të ndryshuar, Si dhe bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 02, datë 27.01.2025, "Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit të ndihmës ekonomike për vitin 2025"; Shkresën e Prefekturës së Qarkut Shkodër për shprehje ligjshmërie nr. 106/1 prot, datë 11.02.2025.

**Situata aktuale e funksionit:**

**Situata financiare :** Në total për Bashkinë Vau Dejës, për Muajin Prill 2025 janë shpallur fitues, 975 familje, me fond 7,528,472 lekë, nga ku 6% e këtij fondi është 451,708 lekë.

**Drejtoria / Sektori përgjegjës:**

Sektori i Fuqizimit Ekonomik, Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Turizmit, Rinisë dhe Sportit Sektori i Ndhmes Ekonomike dhe Pak kane relatuar për projekt vendimin.

**Monitorimi dhe raportimi:** Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, Drejtave të Njeriut dhe Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik dhe Mbikqyrjes Financiare dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë përgjegjëse.

**Impakti social / grupet që preken:** Ky projekt mbetet një mundësi e shkëlqyer për të kontribuar në përmirësimin e kushteve të jetesës së fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre, si dhe në forcimin e rrjetit të mbështetjes sociale që është kaq i nevojshëm për komunitetin.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**A është objekt i konsultimit publik:** Nuk është objekt i konsultimit publik

Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut , i mbledhur me datën 23/05/2025, shqyrtoi projekt vendimit nr.6 datë 09/05/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin "Projekt Vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Shkurt 2025" paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

### VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

Elina Livadhija Kryetar i Komisionit  
(emri, mbiemri, firma)

Molila Zheberaj Zv.Kryetar i komisionit  
(emri, mbiemri, firma)

Loujê Sogaj Sekretar i Komisionit